



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bsc. Fjolla Kmaberi** ,
me titull: “Ndikimi i remitencave në zhvillimin e ekonomive bujqësore në rajonin e Gjilanit”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 13.09.2024 deri me datë _20.09.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Jehoona Shkodra, kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Musliu , mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr Njazi Bytyqi , anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Arben Musliu përmes e-mail adresës:
arben.musliu@uni-pr.edu .

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është të shohim se sa kanë pasur ndikim remitencat në zhvillimin e ekonomive bujqësore në rajonin e Gjilanit, përfshirë këtu dy qytete ,atë të Gjilanit dhe atë të Vitisë, me fshatrat përreth.

Studimi është realizuar me anë të informacioneve primare (në teren) dhe atyre sekondare . Studimi i zhvilluar ka përqendruar vëmendjen në rolet kryesore të bujqësisë në ekonominë e Kosovës dhe ka analizuar ndikimin e remitencave, si një burim të rëndësishëm të financimit, në sektorin bujqësor. Përveç kësaj, është bërë një vlerësim i faktorëve të tjerë që ndikojnë në zhvillimin e këtij sektori, duke përfshirë aspektet sociale, mjedisore dhe teknologjike.

Të dhënat e grumbulluara janë analizuar përmes programit statistikor SPSS. Gjatë hulumtimit, u zbulua një sërë problemesh dhe sfidash që ballafaqohen fermerët në përditshmërinë e tyre. Në këtë kontekst, disa nga problemet emergjente përfshijnë kufizimet e burimeve financiare, mungesën e infrastrukturës moderne bujqësore, dhe ndikimin e kushteve klimatike në prodhimin bujqësor. Në një dimension tjetër, ndikimi i urbanizimit dhe migracionit të popullsisë nga fshatrat drejt qyteteve ka lënë pasojë të ndjeshme në strukturën dhe fuqizimin e forcës punëtore në bujqësi.

Analizat e detajuara kanë sjellë në vëmendje nevojën për strategji të përmirësuara të zhvillimit bujqësor, duke përfshirë investime në teknologji moderne, trajnime për fermerët, dhe politika të fuqishme për mbështetjen e prodhimit vendas. Në këtë kontekst, kemi arritur deri te përfundimi se diversifikimi i prodhimeve bujqësore dhe përdorimi i metodave të qëndrueshme që mund të jenë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshme dhe të përparuar të sektorit bujqësor në Kosovë.

Bazuar në rezultatet e arritura, rekomandohet një përfaqje integrale që përfshinë përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë qeverinë, shoqërinë civile, dhe sektorin privat, në hartimin dhe zbatimin e politikave të efektshme që do të ndihmojnë në promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe inovativ të bujqësisë në Kosovë.

Fjalët kyçe : remitenca , ekonomi bujqësore , ndikim , të ardhurat